

**KONTRATË E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT**

**ndërmjet**

**OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SH.A.  
(‘OST’ SH.A.)**

**dhe**

**FURNIZUESIT \_\_\_\_\_(F)**

Kjo Kontratë për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike lidhet sot më datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_ midis:

Operatori i Sistemit të Transmetimit, (më poshtë referuar si OST sh.a.), shoqëri aksionere, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 31935, datë 14.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, me adresë: Autotrada Tiranë-Durrës, Km 9, Yrshek, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me NIPT Nr. K42101801N, përfaqësuar nga Z. Engjëll Zeqo, Administratori i Shoqërisë, këtu e më poshtë referuar si OST,

dhe

\_\_\_\_\_ (F), regjistruar si person juridik pranë QKR në datën \_\_\_\_\_ me seli në \_\_\_\_\_ me adresë: \_\_\_\_\_ Shqipëri me NIPT Nr \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_, Administrator i Shoqërisë, këtu e më poshtë referuar si \_\_\_\_\_(F)

secila referuar sipas kontratës gjithashtu si “Pala” ose së bashku “Palët” sipas rastit.

## **Baza ligjore**

- a) Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”;
- b) Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016 “Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike”;
- c) Vendimi i Bordit të ERE-s “Për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”;
- d) Kodit i Rrjetit të Transmetimit;
- e) Vendimi Nr. 24, datë 26.03.2009 i Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për rinovimin e licensës në aktivitetin e transmetimit të Energjisë Elektrike Shoqërisë OST sh.a.”;
- f) Vendimit të Bordit të ERE, Nr \_\_\_ datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_ “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 201\_\_”
- g) Vendimi Nr. ...., datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_ i Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licensës si Furnizues i shoqërisë \_\_\_\_\_; Aneks 1

## **NENI 1.**

### **PËRKUFIZME**

Në këtë Kontratë, përfshirë dhe Anekset e saj, përveç kur konteksi e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet si vijon:

**Kontratë** do të thotë kjo Kontratë për Shërbimin e Transmetimit, së bashku me anekset, skedulet dhe dokumentacionin tjetër bashkëlidhur.

**Data e fillimit** do të thotë dita nga e cila kontrata fillon të shtrijë efektet e saj.

**Palët** do të thotë OST sh.a. dhe \_\_\_\_\_ (F).

**OST sh.a.** është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

**(F)-Furnizuesi** është personi juridik i licencuar nga ERE, si furnizues, i cili ka lidhur kontratë të furnizimit me energji elektrike, me klientët fundor, këtu e mëposhtë referuar si \_\_\_\_\_ F.

**Klient Fundor** është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetijak. Këtu e më poshtë referuar si KF

**“Pikat e matjes”** janë pikat e lidhjes së aparateve matës nëpërmjet të cilave bëhet e mundur matja e Energjisë Elektrike që kalon në atë element sipas Aneksit 5 të kësaj kontrate.

**Disbalanca** është diferenca ndërmjet energjisë me bazë orare të nominuar nga F dhe energjisë së matur në pikën (pikat) e matjes të KF respektiv, siç përcaktuar edhe në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, (i ndryshuar).

**Sistem matës** është tërësia e pajisjeve të matjes: matësi, automati, transformatorët e matjes, mbrojtësit e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllore të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike reaktive në pikën e matjes.

**Program** - do të thotë sasia orare e energjisë elektrike që nominohet nga F për furnizimin e KF të tij, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

**Transmetimi** është transporti i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë dhe shumë të lartë, funksioni i të cilit përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

**Sistem i Transmetimit** është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur paralel me sistemet e vendeve të tjera që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçës për lëvrimin e energjisë elektrike tek klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

**Force madhore** “Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë

të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

**Përfaqësues i autorizuar** është personi i ngarkuar zyrtarisht nga Titullari i kompanisë për ndjekjen e kësaj Kontrate.

Çdo term tjetër i përdorur në këtë Kontratë që nuk është përkufizuar këtu më lartë ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s.

## **NENI 2.**

### **OBJEKTI I KONTRATËS**

2.1 Objekti i Kontratës (“Marrëveshja”) është sigurimi i Shërbimit të Transmetimit për \_\_\_\_\_ (F) duke transmetuar nga pikat e marrjes deri në pikat e dhënies, sasinë e energjisë elektrike që \_\_\_\_\_ (F) kërkon të transmetojë, për secilin prej klientëve të evidentuar në Aneksin 2 dhe 5 si dhe rregullimi i marrëdhënieve financiare dhe pagesat midis palëve. Transmetimi i energjisë elektrike, në zbatim të kësaj Kontrate do të fillojë në Datën e Fillimit të parashikuar në Nenin 16.

2.2 Sasia e Energjisë Elektrike dhe periudhat kohore gjatë së cilës do të sigurohet shërbimi i transmetimit nga OST-ja, do të bëhet sipas kushteve të përcaktuara në Aneksin 3 të kësaj Kontratë.

## **NENI 3.**

### **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E OST SH.A.**

3.1 OST sh.a do të sigurojë shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për \_\_\_\_\_ (F), në sasi të dhe për periudhën kohore të specifikuar në Aneksin 2 të kësaj Kontrate, me përjashtim të rasteve të Forcës Madhore ose Rastet e një Ndërprerjeje të Paplanifikuar dhe të Planifikuar (sipas përcaktimeve të bëra në nenet 9, 10 dhe 11 të kësaj Kontratë).

3.2 OST sh.a do të sigurojë këtë shërbim në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016 “Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike”; “Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike” dhe “Kodin e Rrjetit të Transmetimit” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s.

3.3 OST sh.a. ka të drejtë të faturojë dhe arketojë vlerën e shërbimit të kryer në përputhje me këtë Kontratë.

3.4 OST ka të drejtë të reduktojë programin e transmetimit (të furnizimit) për një periudhë të caktuar kohe, duke dhënë dhe shpjegimet përkatëse për këtë reduktim, sipas neneve 9 dhe 10 të kësaj Kontratë.

3.5 OST ka të drejtë të ndërpresë shërbimin në përputhje me nenet 9, 10 dhe 11 të kësaj Kontratë.

#### NENI 4.

##### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ..... (F)**

4.1 \_\_\_\_\_(F) do të informojë OST për sasinë e energjisë elektrike, nominimin me bazë orare, **me numra me presje dhjetore deri ne tre shifra pas presjes**, të energjisë që do të transmetohet për llogari të \_\_\_\_\_ (F) nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për ditën në avancë, jo më vonë se ora 14.00 të çdo dite (në ditën D, për ditën D+1). Për ditët e fund-javës ose të festave, programi do të jepet në avancë, në ditën e fundit të punës dhe do të përfshijë ditët e pushimit dhe ditën e parë të punës pas pushimit. Programi (nominimi) i deklaruar nga \_\_\_\_\_ (F) paraqet një tabelë sipas Aneksit 2, ku për çdo orë të ditës në avancë, jepet energjia (fuqia, kapaciteti në MW) që parashikohet të furnizohet dhe tërhiqet (konsumohet) në të gjitha pikat e matjes sipas Aneksit 5. \_\_\_\_\_ (F) ka të drejtë të bëjë ndryshimin e skedulimit ditor, në çdo kohë, me kushtin që version i ri i skedulimit (nominimit) të jetë harmonizuar më parë me kaunterpartin përkatës (në anën tjetër të kufirit në rastin e importit, ose me centralin furnizues përkatës brenda vendit) dhe të deklarohet në OST, **jo me vone se 90 minuta para bërjes efektive të ndryshimit ne rastin e transaksionit nderkufitar dhe jo me vone se 60 minuta para bërjes efektive të ndryshimit per transaksionin e brendshem në menyre të tillë që nominimi të jetë sa më afer kohes reale të transaksionit të energjisë..**

4.2 \_\_\_\_\_(F) do të përfitojë shërbimin e siguruar nga OST sh.a. në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kontratë dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s.

4.3 \_\_\_\_\_(F) merr përsipër t'i paguajë OST-së për sa është parashikuar në nenin 2.1, çmimin e parashikuar sipas nenit 6.7 dhe të përgjigjet për disbalancat në përputhje me nenin 7 të kësaj Kontratë.

## **NENI 5.**

### **PLANIFIKIMI I KËRKESËS**

5.1 Planifikimi i kërkesës për energji elektrike do të bëhet sipas detyrimeve që kanë palët, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit miratuar me Vendim të Bordit të ERE, Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me Vendim të Bordit të ERE-s dhe Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016 “Modeli i Tregut të energjisë elektrike”. Përgjegjës për parashikimin e ngarkesës që pritet të konsumohet nga KF përkatës, përkundrejt OST, është vetëm \_\_\_\_\_(F) që bën nominimin, dhe jo KF.

## **NENI 6.**

### **SASIA E TRANSMETUAR, ÇMIMI, FATURIMI DHE PAGESA**

6.1 Parashikimet e këtij neni janë të zbatueshme për secilin prej klienteve fundor që furnizohen nga \_\_\_\_\_ (F) dhe për secilën prej faturave që do të bëjë OST, në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të transmetuara për llogari të \_\_\_\_\_(F), me qëllim furnizimin e secilit prej klienteve apo grup klientesh.

OST bën një faturë mujore për çdo F pavarësisht nga numri i KF që ai furnizon.

6.2 OST do të masë sasinë e energjisë së transmetuar për javën paraardhëse, me bazë orare, për llogari të \_\_\_\_\_(F), në pikat e matjes të dhëna në Aneksin 5 dhe do të informojë \_\_\_\_\_(F) me shkrim ("Deklarimi/et) e Matjes nga OST") mbi sasinë e sipërpërmendur, të detajuar për çdo klient fundor (sipas përcaktimeve të Aneksit 4), jo më vonë se ora 12.00 çdo të mërkurë të javës së ardhshme të transmetimit.

6.3 Brenda 3 (tre) ditëve të para të punës, të çdo muaji kalendarik, OST do të informojë \_\_\_\_\_(F) me shkrim (me shkëmbimin midis tyre të dokumentave origjinalë në rrugë zyrtare), mbi sasinë totale të Energjisë Elektrike të Transmetuar, gjatë muajit paraardhës dhe të matur në pikat e matjes.

6.4 \_\_\_\_\_ (F) do të japë konfirmimin e tij ose do të bëjë ankesë në lidhje me saktësinë e të dhënave me shkrim ose fax ose e-mail, brenda 2 (dy) Ditëve të para të Punës nga dita e marrjes së njoftimit nga OST. Pas këtij afati konfirmimi do të quhet i mirëqënë.

6.5 Nëse OST sh.a. e konsideron të justifikuar ankesën do të nxjerrë një raport të ri mujor të cilën ja përcjell \_\_\_\_\_ (F). Në rast se OST e konsideron pretendimin si të pabazuar, njofton \_\_\_\_\_(F) dhe nxjerrë faturën tatimore mujore të shërbimit të transmetimit (këtu e mëposhtë “Fatura”). Fatura do t'i dërgohet \_\_\_\_\_(F) në origjinal. Fatura, do të paraqesë sasinë e energjisë elektrike të transmetuar nga OST në

muajin paraardhës, të matur në pikat e matjes si dhe mund të shprehë por pa u kufizuar të gjitha tarifrat, interesat, pagesat, rimbursimet, dëmet, dhe pagesa të tjera të zbatueshme dhe të detyrueshme për pagesë nga \_\_\_\_\_(F) sipas akt normativës në fuqi në RSH.

6.6 OST do të dorëzojë faturën për shërbimin e kryer sipas nenit 2.1 të muajit paraardhës brenda datës 10 të muajit kalendarik pasardhës. Në rast se data 10 e muajit pasardhës, përkon me një ditë pushimi ose festë zyrtare, dorëzimi bëhet ditën e parë të punës që pason ditën/ditët e pushimit ose festës zyrtare.

6.7 \_\_\_\_\_(F) do të shlyejë tërësisht faturën brenda 10 ditëve pune nga data e lëshimit të faturës nga OST sh.a.

6.8 Në qoftë se \_\_\_\_\_(F), do të kontestojë një informacion si ai i përcaktuar në pikën 6.4 të kësaj Kontratë, atëherë \_\_\_\_\_(F) duhet t'i paraqesë OST-së, brenda 2 (dy) Ditëve Pune nga momenti i marrjes së këtij informacioni në rrugë zyrtare, një shpjegim me shkrim në lidhje me arsyet e kontestimit. OST nga ana e saj brenda 2 (dy) Ditëve Pune të ardhshme duhet të njoftojë me shkrim \_\_\_\_\_(F) për qëndrimin e saj në lidhje me këtë kontestim.

6.9 Në qoftë se \_\_\_\_\_(F) kundërshton në mënyrë të drejtë shumën e një fature të lëshuar nga OST-ja, shuma e padebatueshme do të paguhet në çdo rast në datën e duhur. Kundërshtime në mënyrë të drejtë do të konsiderohen vetëm ato që bëhen për gabimet që rezultojnë nga veprimet e OST sh.a.

6.10 Mbi pagesat e pakryera për shkak të pretendimeve të pabazuara, ose pagesat (tepricat) në faturë që tejkalojnë detyrimin real, do të aplikohet një interes prej 0.5% në ditë për çdo ditë vonese, që do të përlllogaritet si më poshtë:

- a. Në rastin e mospagesës, interesi do të përlllogaritet nga data në të cilën duhet të ishte realizuar pagesa deri në datën që efektivisht realizohet pagesa.
- b. Në rastin e mbipagesës, interesi do të përlllogaritet nga data në të cilën është realizuar pagesa deri në datën që efektivisht realizohet kthimi i vlerës tepër të paguar.

6.11 Pagesa e faturave do të bëhet me transfertë bankare në numrat e llogarive bankare të OST sh.a. si më poshtë:

.....Bank: IBAN: .....

.....Bank: IBAN: .....

.....Bank: IBAN: .....

.....Bank:

IBAN: .....

6.12 Në rast kur \_\_\_\_\_(F) nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST-së, pagesat e pakryera grumbullojnë, një interes prej 0.5 % në ditë, për çdo ditë vonese, deri në datën e kryerjes së pagesës.

6.13 Në rast se \_\_\_\_\_(F) dështon në pagesat e faturave të energjisë elektrike deri në dy muaj pas datës së parashikuar në pikën 6.7, OST sh.a. ka të drejtë të mbajë vlerën e faturës së bashku me normën e interesit të grumbulluar, nga garancia financiare e depozituar nga \_\_\_\_\_(F) për regjistrim në tregun e energjisë elektrike konform rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike të miratuara nga Bordi i ERE.

6.14 Çdo vendimmarrje e ERE në lidhje me çmime/apo tarifa të përcaktuara në këtë Kontratë tip do të aplikohet automatikisht.

## **NENI 7**

### **DISBALANCAT**

7.1 Trajtimi dhe llogaritja e disbalancave të \_\_\_\_\_(F) do të kryhen sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendim të Bordit të ERE-s. Çdo ndryshim i rregullave të tregut në lidhje me çështjen e balancimit do të hyjë automatikisht në fuqi.

## **NENI 8**

### **KONFIDENCIALITETI**

8.1 Palët bien dakort që, për sa është e mundur, me përjashtim të rasteve kur kërkohet nga aktet normative në fuqi (duke përfshirë edhe rregullat e nxjerra nga çdo autoritet rregullator me juridiksion mbi Palën), Kontratat e paraqitura nga palët, së bashku me çdo dokument ose të dhënë të transmetuar një Pale ndaj të tjerave, janë dhe duhet të mbeten konfidenciale. Gjithashtu, asnjë Palë nuk duhet t'ju komunikojë të tretëve (përveç auditëve ose këshilltarëve të saj financiarë ose ligjorë, bankës korrespondente ose çdo organi qeveritar me juridiksion mbi Palën), asnjë nga parashikimet e kësaj Kontrate apo detaje të çdo Kontrate të paraqitur këtu, pa aprovimin paraprak me shkrim të Palës tjetër. Në qoftë se informacioni duhet të jepet, Pala së cilës i kërkohet informacioni duhet të njoftojë Palën tjetër dhe të marrë masa të arsyeshme për të kërkuar mbrojtjen e informacionit të kërkuar nga të tjera kërkesa.

8.2 Parashikimet e bëra në paragrafin 8.1 ngelen në fuqi për 5 vjet nga data e përfundimit të kontratës.



## NENI 9

### FORCA MADHORE

#### 9.1 Raste të Forcës Madhore

Me përjashtim të rasteve shprehimisht të parashikuara në këtë Kontratë, asnjë Palë nuk do të konsiderohet në shkelje të kushteve të kësaj Kontrate në qoftë se provon që moszbatimi i detyrimeve të tyre është i shkaktuar nga një rast Force Madhore. Për efekt të kësaj Kontrate një rast Force Madhore është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të të licencuarit dhe nuk ndodhin për faj të tij dhe i licencuari nuk është në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij.

#### 9.2 Reagimi ndaj një Rasti të Force Madhore

Çdo Palë do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme që të mënjanojë, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, arsyen e çdo vonese ose ndërprerje në zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të limituar dëmet e Palës tjetër. Në qoftë se një Palë merr njohuri për një Rast Force Madhore që do të ndikojë apo mund të ndikojë mbi disa ose të gjitha detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate, detyrohet të njoftojë menjëherë me shkrim Palën tjetër për situatën. Për të fituar kohë, ky komunikim mund të bëhet edhe në rrugë telefonike, por duhet të ndiqet edhe nga një komunikim i menjëhershëm me shkrim. Në të njëjtën mënyrë duhet vepruar edhe në rastet kur ndodh pushimi/mbarimi i rastit të forcës madhore.

#### 9.3 Vazhdimi i kryerjes së detyrimeve

Në rast Force Madhore, palët do të ndërmarrin përpjekjet e tyre më të mira në mënyrë që të:

- (i) Vazhdojnë të kryejnë detyrimet sipas kësaj Kontrate për sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme, duke dhënë informacione të sakta ditore mbi sasinë e Energjisë Elektrike që është e mundur të transmetohet, në varësi të rrethanave.
- (ii) Minimizojë pasojat në lidhje me Rastin e Forcës Madhore.

## **NENI 10.**

### **NDËRPRERJE TË PAPLANIFIKUARA**

10.1 Nëse do të ndodhë një prej ngjarjeve të mëposhtme, OST sh.a. ka të drejtën të ndërpresë transmetimin e Energjisë Elektrike, përsa kohë që vazhdon Ngjarja e Ndërprerjes. Ngjarje të tilla janë:

(i) Prishje e pajisjeve si edhe linjave të transmetimit të OST-së dhe të linjave të transmetimit të interkoneksionit, të cilat nuk mund të parashikoheshin ose riparoheshin.

(ii) Kur OST sh.a. është e detyruar të realizojë kufizime në transmetimin e energjisë elektrike me qëllimin e sigurisë në punë të sistemit elektroenergjitik, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me Vendim të Bordit të ERE.

10.2 OST do të bëjë përpjekjet më të mira të mundshme në mënyrë që të përfundojë sa më shpejt kryerjen e punimeve dhe minimizojë shqetësim/problemet për \_\_\_\_\_(F). OST-ja me anë të një akti teknik do të njoftojë zyrtarisht \_\_\_\_\_(F) në lidhje me Ngjarjen e Ndërprerjes.

## **NENI 11.**

### **NDËRPRERJE TË PLANIFIKUARA**

11.1 Proçesi i ndërprerjeve të planifikuara do të bëhet konform rregullave të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, miratuar me vendim të ERE.

11.2 Në mënyrë që të lejohet \_\_\_\_\_(F) të marrë masat e përshtatshme, OST, në përputhje me programin vjetor të remonteve, të rakorduara mes palëve, do të informojë me shkrim \_\_\_\_\_(F) jo më vonë se 20 ditë para fillimit të punimeve të mirëmbajtjes, duke specifikuar zgjatjen e punimeve dhe objektin (vendin) ku do të kryhen këto punime. Pas këtij njoftimi OST i lind e drejta të fillojë punimet e mirëmbajtjes pa pasur nevojën për një aprovim paraprak nga ana e \_\_\_\_\_(F). Në rast se \_\_\_\_\_(F) ka shkaqe të arsyeshme për të kërkuar mos ndërprerjen e energjisë elektrike, njofton OST-në brenda tre ditë pune nga marrja e njoftimit për remontin.

OST vlerëson kërkesën e \_\_\_\_\_(F) dhe kthen përgjigje mbi panimin ose jo të kërkesës, ditën e nesërme të marrjes së saj.

11.3 OST detyrohet të përfundojë kryerjen e punimeve brenda afatit të njoftuar.

## **NENI 12.**

### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE LIGJET E ZBATUESHME**

12.1 Kjo Kontratë do të zbatohet në përputhje me aktet normative dhe Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

12.2 Në rast të lindjeve të mosmarrëveshjeve në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate, mosmarrëveshja do t'i njoftohet Përfaqësuesve të autorizuar për trajtimin e mosmarrëveshje të çdo Palë, të cilët do të tentojnë me mirëbesim ta zgjidhin atë sa më shpejt që të jetë e mundur. Në qoftë se Përfaqësuesit arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen, zgjidhja do t'ju njoftohet Palëve me shkrim dhe do të jetë detyruese për ato. Në qoftë se Përfaqësuesit nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati kohor të arsyeshëm, ose në qoftë se një Palë nuk arrin të zgjedhë një përfaqësues, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim i ekzistencës së mosmarrëveshjes, atëherë çështja do të zgjidhet nga ERE sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë, Rregullave të Tregut dhe Kodit të Rrjetit.

12.3 Kur mosmarrëveshjet e palëve i referohen interpretimit të Kodit të Rrjetit palët do të veprojnë në përputhje me parashikimet e Kodit të Rrjetit si dhe “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit natyror” për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe vendimi i ERE-s është i detyrueshëm për zbatim nga palët.

12.4 Secila prej palëve ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në rast se nuk është dakort me zgjidhjen e dhënë sipas pikës 12.2.

## **NENI 13**

### **KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE**

13.1 Në rast se Furnizuesi shkel një prej kushteve të kësaj kontrate, apo legjislacionin që rregullon Sektorin e Energjisë Elektrike në fuqi, OST sh.a ka të drejtë të dërgojë një kërkesë të argumentuar për marrjen e masave nga ana e ERE, sipas nenit 42 dhe/apo nenit 107 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

**NENI 14**  
**AUTORIZIMET**

14.1 Palët pohojnë dhe garantojnë se kanë marrë të gjitha autorizimet e nevojshme dhe licencat e kërkuara për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Kontrate.

**NENI 15.**

**NJOFTIMET, PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR ETJ.**

15.1 Menjëherë pas firmosjes së kësaj Kontrate, çdo palë do të përcaktojë me shkrim një Përfaqësues të autorizuar ("Përfaqësuesi i Autorizuar") që do të jetë i autorizuar të ndjekë zbatimin e kontratës .

15.2 Njoftimet, faturat, (që parashikohen në nenin 6.3, 6.4, 6.5 dhe 6.8 më lart) ose dokumenta të tjerë në lidhje me këtë Kontratë do të dërgohen me faks në numrat e përcaktuar më poshtë dhe do të konsiderohen të marra kur aparati që ka dërguar faksin do të ketë konfirmuar transmetimin. Çdo Palë mund të ndryshojë numrin e saj të faksit duke njoftuar me shkrim Palën tjetër. Në rast se njëra palë ka ndryshuar numrin e faksit, pa njoftuar më parë palën tjetër, çdo njoftim i dërguar nga pala tek numri i mëparshëm do të konsiderohet i marrë prej palës që ka bërë ndryshimin dhe nuk ka njoftuar.

15.3 Palët bien dakort që ti njoftojnë strukturat e tyre përkatëse për lidhjen e kësaj Kontrate dhe t'i udhëzojnë ato për detyrimet që rrjedhin prej saj me qëllim marrjen e të gjitha masave për zbatimin e saj.

15.4 Për çdo ndryshim në përcaktimet e bëra në këtë nen, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën brenda 24 orësh.

Personat e autorizuar për të dy palët do të jenë:

Për OST:    Z.        Pozicioni:

OST sh.a.

Autotrada Tiranë- Durrës

Km 9, Yrshek

Kashar, Tiranë

tel: +355 4 2225581 fax: + 355 4 2225581

Për (F): Z. ....

Pozicioni:

Administrator i \_\_\_\_\_(F)

Rruga: ..... Nr: .....

tel: .....

fax: .....

email: .....

## **NENI 16.**

### **AFATI I ZBATIMIT TË KONTRATËS**

16.1 Kjo Kontratë ka afat deri në datën .....dhe i shtrin efektet që nga data e fillimit të zbatimit të kontratës të lidhur midis \_\_\_\_\_(F) dhe çdo klienti fundor, referuar pikës 3 “Kohëzgjatja e kontratës” në Ankesin 2.

16.2 \_\_\_\_\_(F) duhet të njoftojë menjëherë OST-në për përfundimin e kontratës me secilin prej klienteve fundor dhe për ndërprerjen e shërbimit të trasmetimit me qëllim furnizimin me energji elektrike të klientit fundor përkatës \_\_\_\_\_(F), duhet të njoftojë OST-në se ka lidhur kontratë të furnizimit me një klient të ri fundor, tre ditë para datës së furnizimit.

16.3 Kjo Kontratë është e vlefshme dhe i shtrin efektet mes palëve edhe në rast se, gjatë kohës së zbatimit të saj, \_\_\_\_\_(F) njofton se ka ndërprerë kontratën e furnizimit me njërin prej klientëve fundorë ose ka lidhur kontratë të furnizimit me një klient të ri fundor. (F) do të njoftojë menjëherë OST-në dhe palët do të reflektojnë ndryshimet përkatëse në Anekset e kësaj Kontrate. Këto ndryshime nuk do të prekin asnjë prej kushteve të tjera të kësaj Kontrate dhe nuk do t’i nënshtrohen miratimit të ERE të parashikuar në nenin 16.

## **NENI 17**

### **NDRYSHIMET DHE AMENDIMET**

17.1 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate miratohet me vendim të Bordit të ERE.

## NENI 18

### EKZEKUTIMI NGA PALËT

18.1 Kjo Kontratë hartohet në 3 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për OST dhe 1 për Furnizuesit.

18.2 Palët deklarojnë se nënshkrimi i kësaj Kontrate bëhet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe se ky nënshkrim ka fuqi për shoqëritë të cilët ata përfaqësojnë.

## NENI 19

### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

19.1 Palët shprehimisht marrin përsipër dhe premtojnë që:

i) të ndërmarrin veprime të cilat janë të arsyeshme, me ndershmëri, qëndrueshmëri dhe është e rëndësishme të mbajnë vazhdimësinë e shërbimit dhe këtë Kontratë në ekzistencë;

ii) të ndërmjetësojnë dhe ndryshojnë këtë Kontratë nëse do të jetë e nevojshme si rrjedhojë e ndryshimeve në ligj ose akte nënligjore;

19.2 Të gjitha Kontratat e nënshkruara deri më sot për shërbimet e transmetimit midis palëve shfuqizohen.

Tiranë,        /        /

Në emër dhe për llogari të OST sh.a.

Në emër dhe për llogari të \_\_\_\_\_(F)

Administrator

i OST sh.a.

Engjëll Zeqo

Administrator i \_\_\_\_\_ (F)

## **ANEKSI 1**

Vendimi Nr. ...., datë ..... i Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licencës si Furnizues i shoqërisë .....”

## ANEKSI 2

### Formular i Njoftimi i kontratave të lidhura midis \_\_\_\_\_(F) dhe Klientëve Fundor

Për Klientin Fundor: .....

1. Identifikimi i palëve të kontraktuara: \_\_\_\_\_(F) dhe ..... (KF)
2. Pikat e lëvrimet/tërheqjes: Hyrja ....., N/Stacioni .....
3. Kohëzgjatja e kontratës: ..... - .....
4. Sasitë e kontraktuara: ..... MWh



### ANEKSI 3

#### Kushtet për transmetimin e energjisë

OST dhe \_\_\_\_\_(F) do të zbatojnë Rregullat e Tregut, Kodin e Sistemit të Transmetimit, Kodin e Matjes dhe detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë.

OST do të transmetojë energjinë elektrike, sipas programeve të nominuara, në parametrat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe cilësisë së parametrave të kësaj energjie në pikat e marrjes së energjisë sipas specifikimeve dhe parametrave të dhëna në Kodin e Sistemit të Transmetimit.

OST do të aplikojë në faturën e detyrimeve të \_\_\_\_\_(F) për energjinë e transmetuar pagesat apo tarifatat e miratuara nga ERE, të cilat miratohen dhe hyjnë në zbatim përgjatë kohës së zbatimit të kësaj Kontrate.

\_\_\_\_\_ (F) merr përsipër detyrimin për zbatimin e udhëzimeve dhe kërkesave të dhëna nga Operatori Dispeçer i OST, që kanë të bëjnë me dispeçerimin e Sistemit Elektroenergjitik.

\_\_\_\_\_ (F) merr përsipër të njoftojë jo më vonë se 10 ditë më parë OST-në për ndryshime të skemës në rrjetin e tij të shpërndarjes që kanë për pasojë ndryshime të konsiderueshme të kërkesës në një pikë/disa pika marrje të Sistemit të Transmetimit.

Tarifa e transmetimit, fiksuar në këtë Kontratë, nuk ka lidhje me nivelin e tensionit të pikës së marrjes së energjisë apo karakteristikat e konsumatorit që furnizohet nga \_\_\_\_\_(F).

Palët në Kontratë bien dakort se vlerësimi i cilësisë së furnizimit të energjisë elektrike, objekt i kësaj Kontrate, është proces identifikimi, matje dhe arsyetimi në një akt të përbashkët të konfirmuar nga palët.

## ANEKSI 4

### Matja, rakordimet, etj

Matja e energjisë elektrike të transmetuar në Sistemin e Transmetimit nga OST, për llogari të \_\_\_\_\_(F) do të bëhet në pikën/pikat e përcaktuara në këtë Kontratë.

Instalimi, administrimi, rinovimi, kontrolli dhe verifikimi i paisjeve të matjes janë të rregulluara konform përcaktimeve të Kodit të Matjes.

Matja e energjisë elektrike do të bëhet nga OST, për çdo orë të ditës, nga ora 00.00 deri 24.00, me pajisjet, standartet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Matjes.

Faturimi i detyrimeve reciproke, ndërmjet palëve në Kontratë, do të bëhet në fatura mujore mbi bazë të matjeve orare.

OST ka detyrimin për matjen dhe njoftimin e të dhënave nga sistemi i matjes, në përputhje me afatet dhe specifikimet e dhëna në Rregullat e Tregut.

OST do të ofrojë një informacion shtesë nga sistemi i matjes në përputhje me kërkesën e \_\_\_\_\_ (F) për aq sa OST e vlerëson se nuk cënon interesat e palëve të tjera në treg dhe ecurinë normale të Tregut.

Rakordimi i të dhënave të matjes midis palëve është një detyrim që paraprind procesin dhe afatet e faturimit të detyrimeve mujore ndërmjet palëve dhe do të bëhet në afatet dhe sipas Rregullave të Tregut.

OST do të masë sasinë e energjisë së transmetuar të Kontratës për javën paraardhëse për llogari të \_\_\_\_\_(F), në Pikat e matjes dhe do të informojë me shkrim \_\_\_\_\_(F) ("Deklarimi/(et) i/(e) Matjes nga OST") mbi sasinë e sipërpërmendur (sipas përcaktimeve të Aneksit 2), jo më vonë se ora 12.00 çdo të mërkurë të javës së ardhshme të transmetimit.

OST do të masë sasinë e energjisë së transmetuar për llogari të \_\_\_\_\_(F) në të gjitha pikat e matjes në ditën paraardhëse në bazë orare dhe do të informojë me shkrim (e-mail) \_\_\_\_\_(F) mbi sasinë e sipërpërmendur jo më vonë se ora 12.00 e ditës pasardhëse. Për ditët e fund-javës ose të festave, ky informacion do të jepet në ditën e parë të punës pas ditës së pushimit dhe do të përfshijë ditët e pushimit dhe ditën e fundit të punës para pushimit. Sasia e matur nga OST, paraqet një tabelë (worksheet), ku për çdo orë të ditës së mëparëshme, jepet energjia e transmetuar në kWh në çdo pikë matje sipas Aneksit 5.

Meqënëse sistemi i telematjes, për shkak të teknologjisë, mund të ballafaqohet me dështime të transmetimit të të dhënave nga matësi në serverin e qendrës së matjes, por jo dështime të regjistrimit të të dhënave në memorien e vetë matësit, dështime këto që janë mjaft të rralla dhe të shkurtëra në kohë, dhe që njoftohen, sinjalizohen automatikisht nga vetë sistemi i matjes, atëherë të dhënat orare/ditore që do të komunikohen nga operatori i matjes/tregut, kur shoqërohen me shënimin e prezencës së dështimeve të pjesëshme në pikën e matjes përkatëse, duhet të konsiderohen si të dhëna operative (jo përfundimtare, të vlefshme për faturim) që i shërbejnë çdo pjesëmarrësi të tregut për të vlerësuar pozicionin e tij, në lidhje me realizimin e nominimit të deklaruar apo disbalancave përkatëse. Të dhënat (matjet) e pa-transmetuara të ruajtura në memorien e matësit përkatës, do të tërhiqen me ndërhyrje manuale në një kohë të mëvonëshme (jo brenda ditës) dhe do të transmetohen në serverin përkatës në qendër duke ruajtur identitetin e tyre, (orën përkatëse), duke bërë të mundur azhornimin e tabelës orare të matjeve, e vlefshme për njoftimet (deklarimet) me bazë javore, por në mënyrë finale me bazë mujore. Këto të dhëna me bazë orare (të azhornuara në rastet e shfaqjes së dështimeve) do të shërbejnë si bazë për llogaritjen e disbalancave, bilancit energjistik, faturimit etj.

Kur në sistemin e matjes, nuk janë transmetuar të dhënat përkatëse, për shkak të defektit ose rënies së matësit për kërkesën, OST për qëllimet e Likuidimit do të vlerësojë sasinë e transmetuar të energjisë elektrike, bazuar në të dhënat historike dhe në të dhënat e mekanizmave të tjerë matës gjatë periudhës përkatëse.

## ANEKSI 5

### Pikat e Matjes

<u>Emri Klientit Fundor</u>	<u>Emri N/Stacionit</u>	<u>Kodi i Pikës së Matjes në Sistemin e OST</u>